REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe nenit 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019, Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Strehimores " Shtëpia e Sigurt" - Gjakovë Nr.01-360/09-42608 të datës 21.08.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 23.09.2026, dhe vazhduar me datë, 08.10.2026 pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR STREHIMOREN "SHTËPIA E SIGURT" GJAKOVË

I. MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej **5,000.00 €** (pesë mijë euro), për ta mbështetur financiarisht Strehimoren " Shtëpia e Sigurt" në Gjakovë për mbulimin e pjesërishëm të shpenzimeve të Strehimores për ofrimin e mbështetjes së shërbimeve profesionale për fëmijët pa përkujdesje prindërore nga Komuna e Lipjanit të strehuar në shërbimin për fëmijë të Strehimores " Shtëpia e Sigurt" Gjakovë" në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Strehimores "Shtëpia e Sigurt" - Gjakovë Nr.01-360/09-42608 të datës 21.08.2026 dhe Aneksit I cili është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje .

II. Shuma e mjeteve të cekura në pikën **I** të këtij Vendimi do të ndahen nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikuara për Drejtoratin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2026, fondi burimor: 21/613/75511/200//1040.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale .

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Nr. 15-400/01-5157
Lipjan, më 08.10.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi